



# KONFEDERATA E SINDIKATAVE TE SHQIPERISE CONFEDERATION OF THE TRADE UNIONS OF ALBANIA

## REZOLUTË E KONGRESIT TË 5-të TË KSSH

### Barazia gjinore dhe integrimi moshor, pjesë integrale e drejtësisë sociale-

Në kushtet e tranzicionit të zgjatur, të zhvillimeve politike të ashpra e konfliktuale si dhe nën ndikimin e krizës ekonomike e paqëndrueshmërisë ekonomiko-sociale të shoqërisë shqiptare, balancat gjinore dhe përfshirja e integrimi i të rinjve në sindikatë marrin një rol parësor në jetën organizative dhe zhvillimet e brendshme të Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë.

Prandaj nevojitet zhvillimi i politikave kombëtare të mirfunksionimit për të drejtat dhe mundësitë e barabarta për gratë dhe burrat duke krijuar mekanizma konkrete për ballancim gjinor, duke kapërcyer diskriminimin e grave dhe të rinjve. Në lidhje me çështjet e punës, shpërblimet, cilësinë e jetesës, etj.

KSSH në gjithë strategjitë dhe planveprimet e saj, barazinë gjinore dhe përfshirjen e të rinjve në sindikatë e ka pasur dhe do ta ketë pjesë të pandarë të punës dhe aktivitetet sindikal për arritjen e objektivave të saj për të siguruar një drejtësi shoqërore për të gjithë.

- Kongresi i 5-të i KSSH e konsideron domosdoshmëri detyrimin Statutor që 30 % e të gjithë strukturave drejtuese që nga qendra në bazë të jenë gra dhe të rinj.

- KSSH do të punojë me prioritet për zbatimin korrekt ligjor si dhe do të kontribuojë për unifikimin dhe përshtatjen ligjore me ato të BE si dhe do të mbështesë zbatimin e Konventave të ILO-s, si ajo Nr. 100 (Shpërblim të barabartë për gratë dhe burrat (Për punë të barabartë, paga të barabarta). Ajo Nr. 111 (Diskriminim në lidhje me punën dhe profesionin), Nr. 156 (Punonjësit me përgjegjësi familjare), Nr. 183 (Mbrojtja e mëmësisë) etj.

- KSSH mbështet zbatimin e programeve rajonale të punësimit për krijimim e vendeve të sigurta të punës, për trajnimin dhe formimin profesional dhe rikualifikimin e sistemeve për gratë dhe të rinjtë, me qëllim rritjen e prezencës dhe të konkureshmërisë së tyre në tregun e punës.

- Pjesëmarrja e grave dhe të rinjve në grupet e negocimit, hartimit dhe nënshkrimit të kontraktimit kolektiv, KSSH e shikon si domosdoshmëri për të arritur një dialog social konstruktiv e gjithpërfshirës.

- KSSH do ndërmarrë një sërë fushatash dhe aksione për promovimin dhe përfshirjen e grave e të rinjve në sindikatë si dhe përfaqësimin proporcional të tyre në aktivitetet dhe strukturat sindikale me synim që të arrihet një përfshirje e tyre integrale në punë të denjë dhe drejtësi sociale.

**Kongresi i 5-të i KSSH**

**Tiranë, më 30 Nëntor 2014**